

Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë: SHPREHIM NGUSHËLLIMET MË TË NDJERA PËR JETËT E HUMBURA NË LIBAN



Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë shpreh ngushëllimet më të ndjera për familjet e atyre që u goditën nga shpërthimi i djeshëm, si dhe për të gjithë popullin e Libanit.

Jemi të hidhëruar thellë nga vdekja e dhjetëra personave dhe plagosja e mijëra të tjerëve. Lutemi për prehjen e shpirtave të atyre që ndërruan jetë dhe urojmë shërimin e shpejtë të të lënduarve dhe kapërcimin sa më të shpejtë të pasojave.